




Република Северна Македонија

Министерство за внатрешни работи

BROSHURË INFORMATIVE PËR

AZILKËRKUES

Албански јазик





UNHCR
The UN Refugee Agency

Dizajni dhe botimi i kësaj fletushke është përkrahur nga UNHCR - Komisarati i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara - Përfaqësia në Maqedoninë e Veriut. Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet apo qëndrimet e UNHCR dhe nuk e detyron UNHCR-në.

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
Çka është azili?.....	5
Si dhe ku të tregosh qëllimin tënd për të dorëzuar kërkesë për praninë të së drejtës për azil?	6
Si dhe ku dorëzohet kërkesa për azil?	7
Cilat janë të drejtat e tua si azilkërkues?	8
Cilat janë obligimet e tua si azilkërkues?	9
Procedura për njohjen e së drejtës për azil	10
Cili mund të jetë vendimi yt	11
Çka nëse merr statusin e refugjatit?	12
Çka nëse merr statusin e personit nën mbrojtje subsidiare?	13
Çka në rast se kërkesa për azil të refuzohet?	13
Çka nëse i takon grupit të personave të kategorisë së pambrojtur?	14
Informata për procedurën e të drejtës për azil.....	15
Adresa të rëndësishme dhe numra të telefonit.....	16
Hartë	18

PARATHËNIE

I nderuar azilkërkues,

Kjo broshurë synon të jep informata themelore lidhur me procedurën për pranimin e të drejtës për azil në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Domosdoshmëria për broshurë e këtij lloji, del nga fakti se kur ti vjen në një vend si azilkërkues ballafaqohesh me realitet të ri dhe të panjohur.



Qasja në informata të sakta lidhur me njohuritë tua se:

- çka është azili,
- si dhe ku të tregosh qëllimin tënd për të parashtruar kërkesë që të njihet e drejta për azil,
- si të aplikosh për azil,
- ku duhet të aplikosh,
- të drejtat dhe obligimet e tua si azilkërkues,
- procedura për pranimin e të drejtës për azil,
- lloji i vendimeve në lidhje me kërkesën tënde, e drejta e mbrojtjes gjyqësore, dhe
- kujdesi për personat me nevoja të posaçme.

konsiderojmë që do të jenë në dobinë tënde për orientim të drejtë

Me siguri disa nga këto çështje për ty janë të paqarta dhe shpresojmë se me këtë broshurë do të ndihmojmë që të gjesh përgjigje për shumë pyetje për të cilat mendojmë se janë të rëndësishme nga këndvështrimi i azilkërkuesit, që kanë të bëjnë me procedurën për azil.

Gjithashtu, në këtë broshurë do të gjesh adresa dhe numra telefoni të rëndësishëm, të cilat duhet t'i dish, që të orientohesh në rrugën e drejtë.

ÇKA ËSHTË AZILI?

A e ke të njohur terminin azil, çka do të thotë, dhe cilëve persona ju jepet ?

Azili është mbrojtje ndërkombëtare të cilin Republika e Maqedonisë së Veriut ua mundëson personave të huaj/personave pa shtetësi:

- refugjat i pranuar (Refugjat sipas Konventës për Statusin e Refugjatëve nga viti 1951 dhe Protokolit për Statusin e Refugjatëve nga vitit 1967) dhe;
- person nën mbrojtje subsidiare.

Refugjat i pranuar është person i huaj, përkatësisht person i cili për shkak të frikës së arsyeshme se do të ndiqet për shkak racës, fesë, kombësisë, për shkak se i takon një grupi të caktuar social ose për shkak të bindjes së tij politike, është jashtë shtetit nënshtetas i të cilit është, dhe nuk mundet, apo për shkak të frikës së tillë, nuk dëshiron të jetë nën mbrojtjen e atij shteti, ose nëse është pa nënshtetësi është jashtë shtetit në të cilin ka patur qëndrim të zakonshëm, nuk mundet apo për shkak të frikës së tillë nuk dëshiron të kthehet në atë vend.

Person nën mbrojtje subsidiare është person i huaj, i cili nuk cilësohet si refugjatë i pranuar, ndërsa të cilit Republika e Maqedonisë së Veriut do t'ia pranojë të drejtën e azilit dhe do të lejojë të qëndrojë në kuadër të territorit të saj, sepse ekzistojnë arsye të forta të besohet, se nëse kthehet në shtetin shtetas i të cilit është, apo nëse është person pa nënshtetësi, në shtetin në të cilin më herët ka pasur qëndrim të zakonshëm, do të ballafaqohet me rrezik të vërtetë nga lëndime serioze (dënim me vdekje ose ekzekutim, torturë ose me veprime jonjerëzore dhe degraduese ose dënim apo kërcënime serioze dhe individuale për jetën ose personin civil, në mënyrë të dhunës jodiskriminuese, në situatë të një konflikti të armatosur të brendshëm apo ndërkombëtar.

SI DHE KU TË TREGOSH QËLLIMIN TËND PËR TË DORËZUAR KËRKESË PËR PRANIMIN E TË DREJTËS PËR AZIL?

- Person i huaj në kalim kufitar apo në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund të paraqet qëllimin e tij/saj për të dorëzuar kërkesë për t'iu pranuar e drejta për azil, gojarisht apo me shkrim, para nëpunësve të Ministrisë së punëve të brendshme.
- Nëpunësi policor, para të cilit ke paraqitur qëllimin tend për azil, duhet që në afat prej 72 orësh të të udhëzojë të dorëzosh kërkesën tënde për t'iu pranuar e drejta për azil para nëpunësit të Dikasterit për Azil, pranë Zyrës së Dikasterit për Azil.
- Poqëse nuk vepron sipas kësaj, nëpunësi policor vepron në pajtim me Ligjin për të Huaj.

SI DHE KU PARASHTROHET KËRKESA PËR AZIL?

- Azilkërkues është i huaj që kërkon mbrojtje nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe ka parashtruar kërkesë për pranimin e të drejtës për azil, për të cilën nuk është sjellë vendim përfundimtar në procedurën për pranimin e të drejtës për azil.
- Azilkërkuesi duhet që patjetër të kërkojë të drejtë për azil kur të hyjë në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- Kërkesa parashtrohet në policinë e kalimit kufitar, apo në stacionin më të afërt policor, qendër për pranim të të huajve, apo në Dikasterin për Azil. Nëpunësi policor e dorëzon azilkërkuesin në Qendër për pranim të Azilkërkuesve.
- Pas parashtrimit të kërkesës për azil, kryhet biseda e parë me azilkërkuesin.
- Azilkerkuesi I cili qëndron në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, parashtron kërkesë për pranimin e të drejtës për azil deri tek Dikasteri për azil.
- Kërkesa për azil parashtrohet parashtrohet me shkrim apo gojarisht në procesverbal, në gjuhën maqedonase apo në gjuhën e vendit të prejardhjes, në njëërën nga gjuhët ndërkombëtarisht të pranuar, apo në gjuhën në të cilën supozohet që azilkërkuesi e kupton.

CILAT JANË TË DREJTAT E TUA SI AZILKËRKUES?

Pas parashtrimit të kërkesës për azil ti ke të drejtë në:

- Shërbime themelore shëndetësore dhe sigurim social
- Ndihmë juridike dhe përkthyes pa pagesë
- Punë në kuadër të Qendrës për strehim
- Qëndrim dhe strehim
- Arsimim
- Lëvizje të lirë

Përveç kësaj, si azilkërkues, ti ke të drejtë të kontaktosh Zyren e UNHCR-së apo OJQ-të tjera që mund të të japin ndihmë juridike gjatë procedurës për pranimin e azilit.



CILAT JANË OBLIGIMET E TUA SI AZILKËRKUES?

- Të qëndrosh në Qendrën e pranimit apo ndonjë vend tjetër strehimi të caktuar nga Ministria e Punëve dhe Politikës Sociale dhe mos ta lëshosh vendqëndrimin e caktuar nga organi kompetent pa e informuar atë apo pa leje për lëshimin e të njejtës, nëse për atë është e nevojshme;
- Të bashkëpunosh me organet për pranimin e të drejtës për azil, në veçanti t'i japësh të dhënat personale, t'i dorëzosh dokumentet e identifikimit apo edhe tjera që i posedon, të mundësosh fotografimin tënd dhe të jepni gjurmët e gishtërinjve, kontrollin personal dhe kontrollin e bagazhit dhe makinës me të cilën ke arritur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe të japësh të dhëna për pronën dhe të ardhurat e tua;
- T'i nënshtrohesh kontrollit mjekësor, ndihmës mjekësore dhe të vaksinohesh poqëse ke lëshuar ndonjë vaksinim;
- T'i respektosh rregullat e Qendrës për Strehim apo vendit tjetër për strehim të cilin ta ka caktuar Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, dhe te mos sillesh dhunshëm;

PROCEDURA PËR PRANIMIN E TË DREJTËS PËR AZIL

Pas parashtrimit të kërkesës për azil, Dikasteri për Azil do t'ju caktojë intervistë.

Në interesin tuaj është të bashkëpunoni me Dikasterin për Azil dhe t'i tregoni të gjitha faktet dhe arsyet e rëndësishme të kërkesës suaj për mbrojtje ndërkombëtare ne Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe arsyet pse nuk mund të ktheheni në shtetin amë.

Dikasteri për Azil është i obliguar t'i ruajë si të fshehta të gjitha të dhënat e paraqitura gjatë procedurës dhe nuk guxon t'i ndajë ato me organet dhe institucionet e shtetit tuaj.

Gjatë intervistës keni të drejtë për:

- Përkthyes;
- Të intervistoheni nga nënpunës i së njëjtës gjini;

Gjatë kohës së intervistës mbahet procesverbal.

Nëse nuk paraqitesh në intervistë dhe nuk e arsyeton mungesën tuaj, kërkesa jote do të tërhiqet, dhe procedura do të ndërpritet.



CILI MUND TË JETË VENDIMI YT

Varësisht nga faktet dhe dëshmitë të cilat vërtetohen gjatë procedurës, mund të presësh vendim për:



NJOHJE të:

- Statusit të refugjatit të pranuar; apo
- Statusit të personit nën mbrojtje subsidiare



REFUZIM të kërkesës për njohjen e të drejtës për azil

Vendimi me të cilin kërkesa për azil është refuzuar, duhet që patjetër t'i përmbajë arsyet pse është refuzuar, dhe udhezim për veprim të mëtutjeshëm juridik.

ÇKA NËSE MERR STATUSIN E REFUGJATIT TË PRANUAR

Nëse vendimi ndaj kërkesës tënde është status i refugjatit të pranuar, atëherë i kë këto të drejta:

- Leje qëndrimi në afat prej më së paku tre vjet;
- Leje strehimi për më së paku dy vjet;
- Të drejtë sigurimi social;
- Të drejtë sigurimi shëndetësor;

Në fakt, i ke të gjitha të drejtat dhe obligimet si çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përpos:

- Nuk ke të drejtë vote;
- Nuk mund të kryesh pune, të punësohesh, të themelosh shoqatë apo parti politike, por vetëm në rast kur për një të drejtë të tillë është e paraparë në momentin kur merr nënshtetësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut

ÇKA NËSE MERR STATUSIN E PERSONIT NËN MBROTJE SUBSIDIARE?

Poqëse vendimi ndaj kërkesës tëndë është status i personit nën mbrotje subsidiare, atëherë ke të drejtë:

- Leje qëndrimi në afat prej një viti, me mundesi vazhdimi;
- Leje për strehim të përkohshëm në afat prej dy vite;
- Të drejtën e sigurimit social.

ÇKA NË RAST SE KËRKESA PËR AZIL TË REFUZOHET?

Nëse kërkesa jote për pranimin e së drejtës për azil është REFUZUAR, rrëfimi yt nuk ka përfunduar, ke drejtë të:

- Ankese ndaj vendimit të Dikasterit për Azil në Gjykatën Administrative në Shkup, në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit, në procedurë të rregullt.
- Ankesë ndaj vendimit të Dikasterit për Azil në Gjykatën Administrative në Shkup, në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit, në procedurë urgjente.
- Keni të drejtë të qëndroni në Republikën e Maqedonisë së Veriut deri në vendimin përfundimtar të Gjyqit dhe nuk mundet t'ju dëbojnë nga shteti.

ÇKA NËSE I TAKON GRUPIT TË PERSONAVE TË KATEGORISË SË PAMBROJTUR?

Nëse je pjesë e grupit të personave të mitur pa shoqërues, persona me aftësi të kufizuara mendore, persona të paaftë për procese dhe persona të pambrojtur me nevoja të posaçme, do të përcaktohet kujdestar sa më shpejtë që është e mundur, në pajtueshmëri me Ligjin për Familje.



Persona të pambrojtur janë:

- persona të paaftë për procese,
- të mitur,
- të mitur pa shoqërues,
- persona të sëmurë rëndë,
- persona me aftësi të kufizuara në zhvillim,
- të moshuar,
- gra shtatëzëna,
- prindër të vetëm me fëmijë të mitur,
- viktimat të tregëtisë me njerëz,
- persona të cilët kanë qenë të torturuar, dhunuar, apo forma tjera të dhunës psikike, fizike apo seksuale.
- Persona me aftësi të kufizuara fizike

Gjatë zbatimit të Ligjit për mbrojtje ndërkombetare dhe të përkohshme, do të merren parasysh nevojat e posaçme të personave të pambrojtur dhe azilkërkuesve.

INFORMATA PËR PROCEDURËN E TË DREJTËS PËR AZIL



Organi kompetent për udhëheqjen e procedurës tënde për azil në instancë të parë, është Dikasteri për azil, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ke të drejtë t'i kontaktosh rreth procedurës tënde në çdo kohë.

Dikasteri për azil ka zyrat personale në suaza të Qendrës së pranimit.

Nepunësit e Dikasterit për azil, janë në zyrë çdo ditë pune gjatë javës.

Në periudhën kur nëpunësit janë prezent në qendër, mund t'i vizitosh dhe t'ju parashtrosh pyetje rreth procedurës tënde.

ADRESA DHE NUMRA TELEFONI TË RËNDËSISHME

Kur aplikoni për pranim të të drejtës për azil:

**MINISTRIA PËR PUNË TË BRENDSHME
DIKASTERI PËR AZIL**

Goce Dellçev 9, 1000 Shkup (Ndërtesa e TVM-së)

apo në

ÇDO STACION POLICOR

Kur aplikoni për mbrojtje gjyqësore:

GJYQI ADMINISTRATIV SHKUP

Tel. (389 2) 3203-200

Orce Nikolov pn, 1000 Shkup

Kur aplikoni për strehim apo sigurim social:

**MINISTRIA PËR PUNË DHE POLITIKË SOCIALE
DIKASTERI PËR AZIL,**

MIGRACION DHE NDIHMË HUMANITARE,

Tel. (389 2) 3106-371

Dame Gruev nr.14, 1000 Shkup

QENDRA PËR STREHIM TË AZILKËRKUESVE

Tel. (389 2) 2600-221

f. Vizbegovë

Nëse ju duhet ndihmë juridike:

MINISTRIA E DREJTËSISË

Dimitrie Çupovski 9, 1000 Shkup

<http://www.pravda.gov.mk/>

Nëse keni nevojë të kontaktoni me UNHCR:

PËRFAQËSIA E UNHCR-SË NË SHKUP

Urosh Xhudoviq 2a, 1000 Shkup

Tel. (389 2) 3118-641

Fax. (389 2) 3131-040

e-mail: mcdsk@unhcr.org

Harta e lokacioneve më të rëndësishëm

